

## **STATUTI HIDROPLUS SHPK**

Statuti i shoqerise:

### **Kreu I**

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

### **Neni 1 :**

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesil

Sot, me date 12.11.2024, ne themeluesit, kemi krijuar nje shoperi me perjegjesi te kufizuar me emrin **HIDROPLUS SHPK**.

Themeluesit e shoqerise jane:

- Marsel Fejzollari **49%**
- Xhulja Lica **51%**

### **Neni 2 :**

#### **Objekti**

Shoqeria do te realizoje aktivitetet e meposhtme (vetem ne rast se jane te percaktuara): import-eksport, tregtim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshme si produkte pajisje per sistem ngrohje- ftohje, elektriqe, hidraulike, industriale, bujqesore, elektro-shtepiake, kancelari, telekomunikacion dhe pjese kompjuterike. Shit-blerje te makinerive, vajrave, mjeteve dhe pajisjeve te ndryshme per gomisteri, servis, dhe lavazh, si dhe pjese nderrimi per automjete dhe impiante industriale. Realizim i auditimeve mjedisore dhe hartim raportesh per mbrojtjen ndaj zjarrit dhe pasojave mjedisore.

Sherbime pastrimi te siperfaqeve urbane, mirembajtje dhe dekorim i mjedisit urban. Grumbullim, largim dhe transport te mbetjeve urbane. Pergatitje dhe tregtim i pajisjeve, ekspertizave dhe projekteve per vleresimin e ndikimit ne mjedis. Punime ne hapesira te gjelberuara, parqe dhe pyje.

Projektim objektesh te ndryshme dhe ofrim te sherbimeve te projektimit.

Ne sektorin e transportit, shoqeria do te ofroje sherbime brenda dhe jashte vendit per llogari te vet apo te paleve te treta. Ne fushen e ndertimit, shoqeria do te kryeje studime, projektim, konsulencë dhe realizimin e veprave te ndryshme, permes fondeve publike ose private, per qellime shfrytezimi ose administrimi publik dhe/ose privat. Keti perfshihet ndertimi i ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve, hekurudhave, ujesjellesave dhe rrjeteve te komunikacionit dhe energjisë, objekteve turistike, ushtarake, te kultit dhe industriale, si dhe restaurimi dhe rikonstrukioni i veprave artistike dhe montimi i strukturave metalike.

Çdo ndertim tjeter, qe sipas nenit 142 te Kodit Civil perben pasuri te paluajtshme per shkak te lidhjes se perhershme me token, do te perfshihet gjithashtu, duke perjashtuar veprimtarite qe jane ne kundershtim me rregullat ligjore ne fuqi.

### **Neni 3 :**

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete nga data **12.11.2024** e ne vazhdim.

### **Neni 4 :**

Selia

(1) Selia e shoqerise ndodhet ne adresen:Rruga "Gjergj Balsha" Breg Lumi, Nd 139,H1, Njesia bashkiake Nr11, 1031, Tirane.

(2) Adresa e fakes se internetit te shoqerise eshte Hidroplus.al per qellime komunikimi elektronik.

### **Neni 5 :**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte **3,000,000 Leke**.

---

### **Neni 6 :**

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themelues per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te ritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit. Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ortaket ne te njeften mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

### **Neni 7 :**

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pernjegesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- shit-blerjes;
- trashegimise;
- dhurimit;
- cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me ruge trashegimie. E drejta e parablerjes i takon ortakeve.

## KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8 :

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percakuara ne ligj.

Asambleja per gjithshme e ortakeve eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e me poshtrne:

- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- ndryshimet e statutit: emerimin e shkarkimin e administratoreve,
- emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabelte autorizuar,
- percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat ne pikat me siper,
- mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,
- perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit,
- pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise,
- miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese,
- ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortrake tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene per gjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

## **Neni 9 :**

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose. nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet pastes cicktronike. Njoftimi me shkrese apo, me mesazh cicktronik duhet te permbaje vendin, daten. oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar pef mbledhjen e asambfese. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes I te ketij neni. ajo mund te marre vendime te te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord. per te marre 'vendime, pavaresisht parregullsise.

## **Neni 10 :**

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice le zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit" Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ajo mund te marfe vendime te vlefshme vetem. nese ortaket qe zoterojne me shume se giysmen e numrit total te. vorave, jane te pranishem personalisht. votojne me shkrese. apo mjete elektronike, sipas paraçikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumin te permendor me lart. asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te!njeitin tend dite.

## **Neni 11 :**

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme merr vendime me ortaket pjesemarres per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Vendimet merren me shumicen e votave te ortakeve pjesemarrePer ceshtje te tjera si:

- Percaktimi i politikave tregtare te shoqerises.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin e shkarkimine e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve.
- Mbikeqyrjen e zbatmit te politikave tregetare nga administratoret perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurine se veprimtarise, perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Miratimin e rregullave proceduraile te mbledhjeve te asamblese.
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane OKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## Neni 12 :

1. Perjashtimi nga e drejta e votes. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per :

- Vleresimin.
- Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim le tij.
- Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

2. Kur ortaku perfagesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, vleresohet te jete nete njejtin konflikt interesи, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqueson.

## Neni 13 :

### Administrimi

1. Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore shoqerie. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, Me te drejte riparteritjeje.
2. Administratoret e nje shoqerie tregetare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji nuk mund te emerohen si administratore te nje shogerie te kontrolluar e anasjelltas, cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
3. Personat e meposhtem caktohet si Administrator i shoqerise. Te dhenat e identifikimit emri mbiemri : **Marsel Fejzollari**

## Neni 14 :

### Kompetencat e Administratorit

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- Kryejn te gjitha veprimet e administrimit te veprimitarise tregetare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme.
- Perfaquesojne shoqerine tregetare.
- Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise pergatisin dhe nenshkruajne bilancin\_vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimitarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumete perpara asambles se pergjithshme per miratim.
- Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat. qe kercenojne mbarevajtjen e veprimitarise dhe ekzistencen shoqerise.
- Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrushme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

- Raportojne perpara asambles se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut:
  - Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
  - Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne rnenyre tjeter active, te cilat kane një vlereme te larte se 5% te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
  - Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga një ortak pasuri qe kane vlore me te larte se 5% te aseteve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat 2 fundit financiare te certifikuara.
  - Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se një administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.
  - Asambleja e përgjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, regullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

### Neni 15 :

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte per gjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese. Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat per gjithshme te detyrimit te besnikerise sipas neneve 1-1,15, 17 e 18 te ligjit.

Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare administratori detyrohet:

- Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemandje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.
- Te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen te qellimeve te percaktuara.
- Te vleresoje me per gjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim.
- Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit prezent apo te mundshem. Te interesave personale me ata te shoqerise.

- Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojsphem.
- Administratori, gjate kryerjes se detyres se tij per gjigjet ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregetare me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
- Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale sipas pikave te permendura me siper, eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te evituar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
- Administratori eshte i detyruar t'i kompensoje shoqerise demet e shkaktuara ne perputhje me ligjin per tregtaret dhe shoqerite tregtare. Ne veçanti, por pa u kufizuar ne 10 raste, ai nuk duhet te kryeje veprimet e me poshtme:
  - Te paguaje interesa ose divident per ortakët,
  - Te shpërndaje asetet e shoqerise,
  - Te lejoje qe shoqeria te vazhdoje aktivitetin tregtar ne rast se, bazuar ne gjendjen financiare, parashikohet se nuk do te kete aftesi per te permbushur detyrimet.

Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne menyre ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise perfshire edhe demshperblimin financiar nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

### KREU III VITI FINANCIAR

#### Neni 16 :

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti regjistrimit e shoqerise ne Qendren Kombetare te pare financiar fillon nga data Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

#### Neni 17 :

##### Eksperti

- Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise

- Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara te cilat cshte i detyruar qe tja paragese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtua e miratuar mbi bazen e se drejtes vendimore qe ka.

#### KREU IV

##### Neni 18 :

Mosmarrveshja – Likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.
- Me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- Me hapjen e procedurave te falimentimit.
- Nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimitarise, ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007.

##### Per Qendren kombetare te rregjistrimit:

- Me vendim te gjykates, ortaket marrin nje vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke emeruar nje ose disa likuidues dhe duke shnuar ne cdo dokument te nxerre prej tyre emrin e likuiduesit dhe shoqerine ne proces likuidimi.
- Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, perveç rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga ortaket.
- Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates per te caktuar nje likuidues

##### Neni 19 :

Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet ose bashkohet sipas vendimit te mbledhjes se per gjithshme te asamblese se ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2012, per tregtaret dhe shoqerite tregtare.

##### Neni 20 :

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te pote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zbatohen dispozitat e ligjt, per tregtaret dhe shoqerite tregtare" Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21 :**

Persa i perket kalimit te konkurrencest nga ortaket e shoqerise, bazuar ne nenin 17 te ligjit nr. 9901 per shoquerite tregtare, ndalimi i permendor ne piken i shfuqizohet ne rastet kur leshohet nje autorizim me shkrim nga ortaket per kete ceshtje. Ndalimi i permendor ne piken me siper te nenit 17 te ligjit nr. 9901 mbetet ne fuqi edhe pas humbjes se cilesise ose statusit te permendor per ortaket per nje periudhe 1-vjeçare."

**Neni 22 :**

Mosmarrveshjet.

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKET  
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

EMER MBIEMER

Marsel Fejzollari



Marsel Fejzollari

EMER MBIEMER

Xhulja Lica

